



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”, neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 6 lidhur me nenin 7, pika 3, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 35/2012” e në mbështetje të nenit 5, lidhur me nenin 11, të Rregullorës QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 26.04.2018, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

JEPET PËLQIMI-për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15, (pesëmbëdhjetë) deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës si më poshtë;

1. **Parcela**, kadastrale, Nr-2785/3 me sipërfaqe prej **4046m²** me destinim sipas planit rregullativ “**Veprimtari administrativ**”, pasurisë shoqërore në emër të Komuna e Suharekës,
2. **Parcela**, kadastrale, Nr-2785/5 me sipërfaqe prej **1401m²**, me destinim sipas planit rregullativ “**Veprimtari administrativ**”, pasurisë shoqërore në emër të Komuna e Suharekës,
3. **Parcela**, kadastrale, Nr-2785/20 me sipërfaqe prej **8000m²**, me destinim sipas planit rregullativ “**Depo te ndryshme materiale**”, pasurisë shoqërore në emër të Komuna e Suharekës,
4. **Parcela**, kadastrale, Nr-2785/63 me sipërfaqe prej **5000m²**, me destinim sipas planit rregullativ “**Përpunimi i elementeve nga materiale i plastikës, aluminit dhe drurit**”, pasurisë shoqërore në emër të Komuna e Suharekës dhe
5. **Parcela**, kadastrale, Nr-2785/66 me sipërfaqe prej **5000m²**, me destinim sipas planit rregullativ “**Përpunimi i elementeve nga materiale i plastikës, aluminit dhe drurit**”, pasurisë shoqërore në emër të Komuna e Suharekës,

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, afatshkurta dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012” dhe të Rregullorës QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-016-20280
Më datë 26.09.2018

